



Mentor Shyti

## Të kesh një profesion me dritë

“Kam qenë i vogël...im atë kishte një shok saldator në atë kohë dhe mbaj mend që drita shpërhapej sa herë që ai punonte mbi hekur dhe kjo më rrëmbente sa herë e shihja. Nuk e dija që më vonë, krejt rastësisht, e ardhmja ime do lidhej me këtë profesion që atëherë më dukej i magjishëm, e tashti më duket i dobishëm”. Kështu thotë Mentor Shyti, 32 vjeç, me një buzëqeshje të lehtë ndërsa fërkon duart e ashpra dhe ulet në një qoshe të ndërtesës së Birrës “Kaon”. Ka jetuar për shumë vjet në Greqi. U kthye pasi pa një rreze shprese për kurse profesionale saldatori, të publikuar në faqen online shqiptarja.com, në rubrikën “Drejt Punës”.

“Media ende nuk e di se sa fuqi mund të ketë t’i ndryshojë jetën një njeriu,

## Having a profession with light

“I was very little ... my father had a friend, a welder at the time and I remember the light spreading every time he worked on iron and that just blew me away every time I saw it. I did not know that later, by pure accident, my present would be linked to this profession that, at that time, seemed magical, and now is useful.” That is what Mentor Shyti, 32, says with a light smile as he rubs his harsh hands and sits down at the corner of the “Kaon” Beer factory. He lived for many years in Greece. He returned after seeing a ray of hope for vocational welding courses published in the online page of shqiptarja.com, in the supplement “Toward Jobs.”

“Media still does not know how much power it has to change the life of a

**dhe familjes së tij”,** thotë Mentor Shyti. **“Gjendja në Greqi po përkeqësohej, punoja me raste në ngarkim-shkarkim mallrash, por kontrolloja vazhdimisht portalin me shpresën se do të gjeja veten në një zanat të përshtatshëm dhe të kthehesha i sigurtë në atdhe.”**

Ideja e tij mori formë pas intervistës në programin **“Drejt punës”** transmetuar në Report TV me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional nr.4 në Tiranë, Z. Piro Jani, i cili, energjik, pati shpalosur mundësitë për profilet e formimit profesional dhe hapësirat për të zgjedhur zanatin që ofronte kjo qendër për të rinjtë.

Mentor Shyti ndoqi më përpikmëri të katër kategoritë e profesionit të saldatorit. U udhëhoq nga një profesionist i vërtetë siç ishte Agim Rrapushi dhe mori të gjithë teorinë dhe praktikën e saldimit. Tashmë bisedën e bëjmë tek qendra e tij e punës, tek Birra Kaon, pozicion që e fitoi lehtësisht pas trajnimit.

**“Diploma është kartë e domosdoshme për të qenë ballëllart përpara çdo kompanie serioze. Çdo profesion paketohet me teori dhe praktikë dhe të rinjtë duhet të nxiten ta kenë këtë armë shumë të vlefshme për zhvillimin e tyre dhe punësimin e sigurtë”,** thotë Drejtori Rajonal i Formimit Profesional, Z. Piro Jani.

Ndaj mjafton një nismë, një hapësirë, një ide e mirë zhvillimi dhe të rinjtë shqiptarë përgjigjen, sepse duan të punojnë. Shqiptarja.com e hapi këtë dritare katër kanate dhe i dha zë një teme themelore për dinjitetin e të rinjve siç është puna e kualifikuar.

**person and his family,”** Mentor Shyti says. **“The situation in Greece was worsening; I worked occasionally on uploading and downloading goods, but constantly checked the portal in the hope that I would find myself in a fitting profession and return safely to my homeland.”**

His idea took shape after an interview on the program “Toward Jobs” on Report TV with the Director of Regional Vocational Training Directory No. 4 in Tirana, Mr. Piro Jani, who energetically explained the opportunities for the profiles of vocational training and the range of possibilities offered by this center for youth to choose a profession.

Mentor Shyti went through the four categories of the welder’s profession. He was led by a true professional such as Agim Rrapushi and obtained all the knowledge on the theory and practice of welding. Now, we talk to him at his workplace, Kaon Beer, where he easily got a job after his training.

**“A diploma is an indispensable piece of paper for allowing you to hold your head high up when meeting an employee. Any profession is packaged with theory and practice and the youngsters must be encouraged to have this very useful weapon for their professional development”,** - says the Regional Director of Vocational Training, Mr. Piro Jani.

That is why one initiative, one space, one good idea for development will suffice for Albanian young people to respond, because they want to work. Shqiptarja.

Programi “Drejt Punës” në report TV, së bashku dhe suplementin “Drejt Punës” të gazetës Shqiptarja.com, dhe të portalit online, si edhe programe e tjera të radios dhe televizionit, janë rezultat i një ndërhyrjeje dy-vjeçare të iniciuar nga RisiAlbania, një projekt i mbështetur nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation dhe Partnerët Shqipëri.

Këto prodhime mediatike janë mbështetur nga projekti, si një strategji për të ndryshuar perceptimin publik dhe për të përmirësuar të kuptuarit rreth tregut të punës në Shqipëri. Dhe rezultatet kanë qenë mbresëlënëse: Gjatë dy viteve të transmetimit dhe publikimit të këtyre programeve, 78,000 individë kanë ndryshuar perceptimet e tyre rreth punësimit, ndërsa 53,000 kanë ndryshuar në mënyrë aktive qëndrimin e tyre dhe kanë ndërmarrë veprime bazuar në informacionin e marrë nga këto programe.

*(Burimi: Matja e pavarur e audiencës dhe impaktit së programve, maj 2016)*

com opened this window and gave voice to an important topic for the dignity of youth.

The program “**Toward Jobs**” on Report TV, together with the supplement “**Toward Jobs**” of the newspaper Shqiptarja.com, and the online portal, as well as the TV and Radio programmes are the result of two years of work initiated by RisiAlbania, a project supported by the Swiss Development and Cooperation Agency (SDC) and implemented by HELVETAS Swiss Intercooperation and Partners Albania.

These media products were supported by the project as a means to change public perception and to improve the understanding of the labor market in Albania. Results have been impressive: during the two years of the broadcast and publication of these programs, 78,000 individuals have changed their perception of employment and 53,000 have actively changed their attitude and have undertaken action based on information obtained through these programs.

*(Source: Independent audience and program impact measurement, May 2016)*

